



Pranuar / Dorezuar Priljeno/Prodato Received/Delivery	26.10.2023	3	viti god year
Organ /Njesia Organ /Jedinica Org /Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicitna Quantity
SKIMSHTOK	6704/2023		119



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic o Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD OR THE CIVIL SERVICE O KOSOVA

A.nr.1131/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Eshref Shabani-kryetar, Malsore Gashi Bajraktari dhe Ardita Haxhnikaj-Demi-anëtarë me Flakron Gashi- Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, në procedurë sipas ankesës A.nr.1131/2023 të datës 31.08.2023 të parashtruar nga ankuesi [redacted] me adresë:

[redacted] në çështjen juridike "Kompensim material", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3, nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës si dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 26.10.2023, mori këtë:

V E N D I M

Refuzohet si e pabazuar ankesa me numër A.nr.1131/2023 e datës 31.08.2023 e parashtruar nga ankuesi [redacted]

A r s y e t i m

Ankuesi, [redacted] sipas shkresave të lëndës i punësuar në Komunën e Lipjanit, me datë 29.08.2023 përmes poste ka parashtruar ankesë e cila në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës është pranuar me datë 31.08.2023 kundër Përgjigjes së datës 15.08.2023 të Njesisë për Menaxhimin e Njesisë së Burimeve Njerëzore me pretendimin ankimor që të rivlerësohet çështja e vlerës së koeficientit lidhur me pozitën të cilën e ka ushtruar në cilësi të zëvendësuesit me kërkesën për pagesën e diferencës së pagës në mënyrë retroaktive nga data 26.01.2023 deri me datë 30.06.2023.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datë 04.09.2023, ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë në Komunën e Lipjanit, ndërsa me datë 05.09.2023, Këshilli ka pranuar përgjigjen në ankesë së bashku me shkresat e bashkëngjitura të lëndës, kurse me datë 12.10.2023 Këshilli sërish i është drejtuar Komunës së Lipjanit me kërkesën për sqarime

shtesë, ndërsa kjo e fundit me datë 13.10.2023 ka përcjellë sqarimet e nevojshme për këtë procedurë.

Sipas kërkesës së Kryetarit të Kolegjit, me datë 12.10.2023 Kryetari i Këshillit ka nxjerrë Vendimin me shifër VK/2023 dhe numër protokolli:6527/2023, përmes së cilit ankesës së ankuesit A.nr.1131/2023 të datës 31.08.2023 ia ka vazhduar afatin vendimmarrës edhe për dhjetë (10) ditë pune.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, për vendosje meritore, ka administruar këto prova: Ankesën e ankuesit të parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës të datës 31.08.2023; Vendimin e Kryetarit të Komunës së Lipjanit i datës 26.01.2023; Vendimin e Kryetarit të Komunës së Lipjanit i datës 26.01.2023; Pëlqimin e datës 25.01.2023; Vendimin e Kryetarit të Komunës së Lipjanit i datës 25.05.2023; Vendimin e Kryetarit të Komunës së Lipjanit i datës 21.06.2023; Kërkesën e ankuesit të datës 14.08.2023; Përgjigjen e datës 15.08.2023; Zarin postar me shifër R5549942; Kërkesën për përgjigje në ankesë të datës 04.09.2023; Përgjigjen në kërkesë e datës 05.09.2023; Akt emërimit të datës 21.02.2022; Përshkrimin e detyrave të punës për pozitën Zyrtar për Vlerësimin e Pronës së Paluajtshme; Listën e pagave për muajin janar, shkurt, mars, prill, maj, qershor, korrik dhe gusht të vitit 2023; E-mailin e datës 12.10.2023 dërguar nga Këshilli për Komunën e Lipjanit; E-mailin e datës 13.10.2023 dërguar nga Komuna e Lipjanit për Këshillin.

Kolegji i Këshillit nga analizimi i shpresave të lëndës si dhe shqyrtimi i pretendimeve ankimore, konstatoi se ankesa e ankuesit _____ është e pabazuar, sepse:

Kolegji i Këshillit duke u bazuar në shkresat e lëndës, gjegjësisht Aktin e Emërimit me numër: AE.Nr.01-112-9543 të datës 21.02.2023, rezulton se ankuesi është e punësuar në pozitën e punës "Zyrtar për Vlerësimin e Pronës së Paluajtshme", në Drejtorinë për Buxhet dhe Financa të Komunës së Lipjanit me koeficient të pagës gjashtë (6), sipas sistemit të vjetër të pagave, ndërsa me pëlqimin e tij Kryetari i Komunës së Lipjanit përmes vendimit të datës 26.01.2023 të njëjtin e ka transferuar përkohësisht deri me datë 26.07.2023 në pozitën "Udhëheqës i Sektorit për Mirëqenie Sociale" me koeficient shtatë (7) sipas sistemit të vjetër të pagave, pozitë kjo në kuadër të Drejtorisë për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale.

Po ashtu, Kolegji i Këshillit ka gjetur se Kryetari i Komunës së Lipjanit me datë 25.05.2023 ka nxjerrë vendimin përmes së cilit ankuesit ia ka njohur të drejtën e kompensimit në mënyrë retroaktive për periudhën kohore sa ka qenë duke e ushtruar pozitën "Udhëheqës i Sektorit për Mirëqenie Sociale" mirëpo pa përcaktuar shumën apo nivelin e koeficientit sipas së cilit i njëjti do të kompensohet në mënyrë retroaktive pavarësisht faktit se sipas vendimit fillestar ishte përcaktuar se i njëjti do të kompensohej përlllogaritur me koeficientin shtatë (7) sipas sistemit të vjetër të pagave, ndërsa me datë 21.06.2023 Kryetari i Komunës së Lipjanit ka nxjerrë vendimin me shifër 01-112/02-32083 përmes të cilit ankuesin e kthen në pozitën që e mban sipas aktit të emërimit dhe më këtë rast shfuqizohen dy vendimet paraprake, respektivisht vendimin e datës 26.01.2023 për transferimin e ankuesit si dhe Vendimin e datës 25.05.2023 për kompensimin e të njëjtit në mënyrë retroaktive, kurse sipas shkresave të përcjella nga Njësia e Burimeve Njerëzore konstatohet fakti se ankuesit së bashku më pagën e muajit maj i është kompensuar edhe shuma në vlerë prej 835.07 Euro/cent.

Me qëllim të shqyrtimit të ligjshmërisë së pretendimeve ankimore të pretendimeve ankimore të ankuesit, Kolegji i Këshillit ka analizuar dispozitat e Ligji Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik lidhur me çështjet e transferimit të nëpunësve civil, gjegjësisht nenin 52 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 ku përcaktohet se: *“Nëpunësi civil mund të transferohet përkohësisht në një pozitë tjetër të Shërbimit Civil të së njëjtës kategori, në këto raste: 1.1. kur është në interes të institucionit, deri në 6 muaj gjatë 2 vjetëve”*, ndërlidhur me nenin 4 paragrafi 1 dhe nenin 5 paragrafi 2 të Rregullores Nr.14/2020 për Transferimin e Nëpunësve Civil ku përcaktohet se: *“4.1. Nëpunësi civil mund të transferohet përkohësisht në një pozitë tjetër të shërbimit civil të së njëjtës kategori brenda dhe jashtë institucionit të administratës shtetërore dhe institucionit tjetër shtetëror sipas rasteve të përcaktuara në nenin 52. paragrafin 1 të Ligjit; 5.2. Transferimi i përkohshëm në interes të institucionit, miratohet nga njësia përgjegjëse, e cila njofton me shkrim nëpunësin civil që do të transferohet. Për marrjen e këtij vendimi njësia përgjegjëse mbështetet në analizën e plotësimin nga ana e nëpunësit të kriterëve të pozitës të punës ku ai kërkohet të transferohet”*, dhe ka ardhur në përfundimin se nëpunësit civil mund të transferohen në interes të institucionit, mirëpo në secilin rast duke respektuar kriteret apo parakushtet ligjore nga dispozitat e cekura si më lartë, nga rrjedh se nëpunësit civil apo në rrethanat e rastit konkret transferimi i ankuesit sipas Vendimit të Kryetarit të Komunës së Lipjanit të datës 26.01.2023 ka qenë i paligjshëm për shkak se sipas neni 33 paragrafi 2 i Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë ka përcaktuar se: *“Pozitat në Shërbimin Civil ndahen në këto kategori: 2.1. Kategoria e lartë drejtuese, që përfshin këto pozita: sekretar i përgjithshëm, drejtor ekzekutiv dhe zëvendësdrejtor i një agjencie ekzekutive, si dhe pozitat e barasvlershme; 2.2. Kategoria e mesme drejtuese, që përfshin këto pozita: drejtor i departamentit dhe pozitat e barasvlershme me të; 2.3. Kategoria e Ulët Drejtuese, që përfshin këto pozita: shefi i divizionit dhe pozitat e barasvlershme me të; dhe 2.4. Kategoria profesionale, që përfshin zyrtarët profesionalë”*, ndërsa në kuptim të nenit 12 paragrafi 5 të Rregullores Nr.10/2022 për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil ndërlidhur me Shtojca Nr.1/5: Përshkrimi i Përgjithshëm i Punës për klasën Drejtues i Ulët të së njëjtës rregullore, Kolegji i Këshillit konstaton se pozita të cilën e ka ushtruar përkohësisht ankuesi *“Udhëheqës i Sektorit të Burimeve Njerëzore”* hynë në **Kategorinë-Drejtues i Ulët: “Udhëheqës i Divizionit/Sektorit në Agjenci Ekzekutive, Komunë dhe Institucion të Administratës së Shërbimeve Publike”** ndërsa pozita të cilën e mban ankuesi sipas akt emërimit të datës 21.02.2023 hynë në kuadër të Kategorisë Profesionale, sikurse edhe fakti tjetër se marrja e vendimit për transferimin e nëpunësve civil është në përgjegjësi të Njesisë Përgjegjëse-Njesisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzor, respektivisht pozita në të cilën ankuesi është transferuar dhe pozita të cilën ankuesi e mban sipas aktit të emërimit nuk janë pozita të së njëjtës kategori, e që në këtë rast një transferim i tillë nuk do të duhej realizohej ngase bie ndesh me nenin 52 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 Ligji Lr.06/L-114 për Zyrtarët Publik dhe nenin 5 paragrafi 2 të Rregullores Nr.14/2020 për Transferimin e Nëpunësve Civil, gjegjësisht përveç tjerash vendimi është marr nga organi jo kompetentë, pasi që ligji material respektivisht Rregullorja Nr.14/2020 për Transferimin e Nëpunësve Civil këtë të drejtë ia ka njohur Njesisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore të institucionit.

Kolegji i Këshillit duke marrë për bazë dispozitat e nenit 132 paragrafi 6 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative ku përcaktohet se: *“Ankesa nuk do të përkeqësoj situatën juridike në dëm të palës që ka paraqitur ankesë, përpos nëse shprehimisht është paraparë ndryshe me ligj”*, dhe duke marrë për bazë Vendimin e kryetarit të Komunës së Lipjanit të datës 21.06.2023 përmes të cilit ankuesi është kthyer në pozitën e mëhershme që e mban sipas aktit të emërimit si dhe janë shfuqizuar dy aktet të cilat janë objekt i shqyrtimit në këtë procedurë, respektivisht Vendimi i datës 21.06.2023 përmes të cilit ankuesi është transferuar si dhe Vendimit të datës 25.05.2023

përmes të cilit ankuesit i është njohur e drejta për kompensim, andaj Kolegji i Këshillit duke respektuar parimin e përcaktuar në dispozitat e Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative nuk mund ta përkeqësoj situatën juridike në dëm të palës dhe ka vendosur sikurse në dispozitiv të këtij vendimi, ngase palët në procedurë duhet ta kenë parasysh faktin se nuk mund të përftojnë kompensim material në emër të vendimeve të cilat janë nxjerrë në kundërshtim me dispozitat e ligjit material ku si rrjedhojë janë vendime të kundërligjshme, respektivisht në kundërshtim me dispozitat e nenit 52 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 Ligji Lr.06/L-114 për Zyrtarët Publik dhe nenin 4 paragrafi 1 dhe nenin 5 paragrafi 2 të Rregullores Nr.14/2020 për Transferimin e Nëpunësve Civil, prandaj edhe pretendimi i ankuesit se kompensimi i realizuar ndaj tij është më i ulët sesa që do të duhej të ishte për periudhën kohore 26.01.2023 deri me datë 30.06.2023, nuk është i bazuar për arsyen e dhënë si më lartë, ngase vetë vendimi për transferimin e tij ka qenë i kundërligjshëm.

Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar nenin 6 paragrafi 1, nën paragrafi 1.1 si dhe nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Këshillë juridike: Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit. Pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës
Lënda me numër **A.nr.1131/2023**

Flakron Gashi

Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional

Eshref SHABANI

Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit
- Kryetarit të Komunës së Lipjanit;
- Udhëheqësit të Personelit në Komunën e Lipjanit, dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së,